

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI
TE KUFIZUAR “Menzy” sh.p.k.**

Themeluesit me poshtë:

- **Mentor Toma**, i biri i Ferit-it, i datëlindjes **06-08-1986**, **banues ne Tirane shtetas** Shqiptar identifikuar nga letërnjoftimi elektronik nr. 033903909 , dhe ID. I60806003A qe ne vijim do te quhet “Ortak”.
- **Zyhni Dika**, i biri i Ismail-it, i datëlindjes **15-07-1989**, **banues ne Tirane shtetas** Shqiptar identifikuar nga letërnjoftimi elektronik nr. 032498545 , dhe ID. I90715014O qe ne vijim do te quhet “Ortak”.

Sot me date 23-08-2021, bazuar në vullnetin e tyre te lire dhe ne përputhje me ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 “Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare”, vendosen te themelojnë shoqërinë tregtare me përgjegjësi te kufizuar sh.p.k “Menzy” sh.p.k ne baze te kushteve qe vijojnë:

KREU I

EMERTIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISE, SELIA, REGJIMI JURIDIK

Neni 1

EMERTIMI

Ortaket vendosen që shoqërinë ta emërojnë “Menzy” sh.p.k.

Neni 2

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria ka ketë objekt veprimtarie:

Import-eksport dhe tregtimin e te gjitha llojeve te materialeve, makinerive pajisjeve dhe impianteve te ndryshme te karakterit elektrik, elektronik, te telekomunikacionit, te destinuara për objekte apo impiante civile dhe industriale.

Projektim, zbatim, mirëmbajtje dhe asistence teknike për Impiante elektrike civile dhe industriale, Automatizimin e linjave te proceseve te ndryshme Industriale, Automatizim civil



(Home Automation), Sisteme mekatronike, Sisteme BMS dhe Impianteve MNZ, sistemeve te sigurisë dhe monitorim me kamera CCTV.

Shoqëria mund te kryeje gjithashtu te gjitha operacionet tregtare industriale, mbi pasuri te luajtshme apo te paluajtshme, qe do te vlerësohen te nevojshme apo te dobishme për realizimin e objektit te shoqërisë si dhe te blejë pjesëmarrje ne kapitale themelte te shoqërive te tjera qe kane objekt te ngjashëm apo te afërt me te vetin etj.

Projektim, ndërtim, mirëmbajtje dhe asistence teknike te centraleve gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga burime te rinovueshme si dielli ose era, Hidrocentrale dhe termocentrale.

Zhvillimin e trajnimeve ne fushën e Automatizimit Industrial dhe Civil.

Neni 3

SELIA E SHOQERISE

Selia e shoqërisë gjendet ne adresën, Rruga Ardeno, Nd. 67, Fushe Mëzez, Tirane.

Shoqëria mund të ndryshoje selinë e saj me vendim te Asamblesë se Ortakeve (ortakut te vetëm).

Neni 4

Shoqëria e zhvillon aktivitetin ne përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe me statutin e saj, ne territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj. Shoqëria mund të krijoje qendra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi e agjenci ne qytete te tjera te Shqipërisë ose jashtë vendit.

Neni 5

Regjimi Juridik

5.1 Shoqëria është shoqëri me përgjegjësi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe legjislacionit ne fuqi ne Shqipëri.

5.2 Me vendimet e tyre ortaket mund te ndryshojnë regjimin juridik te Shoqërisë n.q.s. ne te ardhmen krijojen kushte me te përshtatshme për funksionimin e saj. Ne ketë rast ortaket do te përshtatin Statutin e Shoqërisë, si dhe do te bëjnë regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar ne organet kompetente shqiptare.

5.4 Shoqëria gjëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendrën kombëtare te Regjistrimit dhe ne përputhje me ligjin.

5.5 Shoqëria do te ketë vulën e saj.

Neni 6
FUSHA E AUTORITETIT TE ORTAKEVE

Fusha e autoritetit te ortakeve dhe përqindja e fitimeve dhe humbjeve do te kenë si kriter baze kapitalin e shoqërisë si dhe kompetencat qe gëzon ne marrjen e vendimeve te çdo karakteri, te përcaktuara ne ketë statut.

Neni 7

KONFIDENCIALITETI

Ortaket, si dhe personat e tjerë te pranuar ne shoqëri, bien dakord qe te mos i ekspozojnë asnjë personi te jashtëm informacionet qe do te disponoje shoqëria, kontratat qe ajo do te lidhe, si dhe planet ose qëllimet qe ajo ka për te ardhmen e saj.

Neni 8

Te gjithë aktet dhe dokumentet qe nxirren nga shoqëria dhe te destuguara për te tretet, si: letrat, faturat, lajmërimet dhe publikimet e ndryshme etj. duhet te tregojnë lexueshëm: emrin e shoqërisë dhe pas tij fjalët- shoqëri me përgjegjësi te kufizuar, ose inicialet-sh.p.k dhe emrin e administratorit.


Kreu II

TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

Neni 9

Te drejtat e Shoqërisë dhe te Ortakeve

- 9.1** Shoqëria ka te drejte te lidhe marrëveshje dhe te nënshkruaje kontrata ne territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj .
- 9.2** Shoqëria gëzon te drejtën te krijoje pasuri materiale dhe intelektuale.
- 9.3** Shoqëria ka te drejte te marre pjese si ortake ne shoqëri ose ndërmarrje te ndryshme ne Shqipëri ose jashtë saj, ne përputhje me legjisacionin shqiptar.



9.4 Shoqëria përgjigjet ndaj te tretave vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqëror te derdhur dhe me te mirat e pasurisë se saj. Ajo ne asnjë rast nuk përgjigjet për detyrimet e ortakeve dhe as këto te fundit nuk mbajnë përgjegjësi personale për detyrimet qe merr përsipër shoqëria.

9.5 Ortaket kane te drejte te marrin te gjitha informatat qe kane te bëjnë me veprimtarinë prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te Shoqërisë, si bilancet, llogaritë ekonomike, etj.

9.6 Ortaket përballojnë humbjet e shoqërisë vetëm dhe deri ne kufirin e vlerës se kontributeve te tyre ne kapitalin themeltar.

Neni 10

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë është me afat të pacaktuar.

Kreu III

KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

Neni 11

11.1 Kapitali themeltar është **100,000** (njëqindmijë) leke dhe është i ndare ne **2** kuota.

11.2 Ndarja e pjesëve ne kapitalin themeltar është :

- **Mentor Toma** **1** kuote përkatesisht **50 %** te shoqërisë me vlere **50,000** (pesëdhjetëmijë) leke.
- **Zyhni Dika** **1** kuote përkatesisht **50%** te shoqërisë me vlere **50,000** (pesëdhjetëmijë)leke.

Kapitali i shoqërisë mund te shtohet ose te pakësohet sipas vendimeve qe do te marrin Ortaket.

11.3 Ky kapital nuk mund te jete me i vogël se minimumi i përcaktuar me ligj.



Neni 12

Transferimi i pjesëve te kapitalit themeltar

- 12.1** Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht te transferueseje midis ortakeve te shoqërisë.
- 12.2** Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen, nga ortaket, personave te trete, qe nuk bëjnë pjesë ne shoqëri, vetëm me miratimin e ortakeve te shoqërisë.

Kreu IV

DREJTIMI DHE ORGANET KRYESORE

Neni 13

- 13.1** Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit dhe në përputhje me ligjin.
- 13.2.** Emërtimi i shoqërisë tregtar, kapitali themeltar, NIPT-i duhet te jene të përmendura ne te gjitha aktet dhe dokumentet qe nxjerr kjo shoqëri dhe ju drejtohen te treteve.
- 13.3.** Organet kryesore te shoqërisë janë: Asambleja e Përgjithshme e përberë nga ortaket dhe administratoret.

Neni 14

Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë

Asambleja e Përgjithshme përbehet nga ortaket e shoqërisë qe është organi me i larte vendimmarrës i shoqërisë dhe vendimet e tyre janë te detyrueshme. Te drejtat dhe detyrimet e Asamblesë se Përgjithshme ushtrohen nga ortaket. Te drejtën e thirrjes se Asamblesë e kane Administratoret , Eksperti kontabël i autorizuar ose ortaket e shoqërisë. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postes elektronike.



Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te përmbaje vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakeve, jo me vone se shtate dite përparrë datës se parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Ortaket mund te përfaqësohen ne asamble nëpërmjet një përfaqësuesi, duke qene i autorizuar me prokure te posaçme, dhe te marrin vendime vetëm për ato çështje qe diskutohen ne mbledhjen për te cilën ata kane marre te drejtën e përfaqësimit.

Mbledhjet e asamblesë pasqyrohen ne procesverbalin qe mbahet me ketë rast, ndërsa vendimet nënshkruhen nga ortaket.

Procesverbalet e mbledhjeve ruhen ne selinë e shoqërisë.

Te gjitha vendimet e marra nga ortaket regjistrohen ne një regjistër te vendimeve, të dhënat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen.

Ortaket e shoqërisë kane te drejte te marrin vendime për çështjet e mëposhtme:

- a) Përcaktimin e politikave tregtare te shoqërisë.
- b) Ndryshime e statutit.
- c) Emërimin e shkarkimin e administratoreve.
- ç) Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabël te autorizuar.
- d) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur ne shkronja "c" dhe "ç" te kësaj pike.
- dh) Mbikëqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret përfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurisë se veprimtarisë.
- e) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurisë se veprimtarisë.
- ë) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit.
- f) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- g) Përfaqësimin e shoqërisë ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- gi) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- h) Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblesë.
- i) Çështje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Kreu V
ADMINISTRIMI

Neni 15

15.1. Shoqeria do te administrohet nga 1 (një) administrator, qe mund te zgjidhet edhe jashtë ortakeve te shoqërisë.

15.2 Administratoret emërohen dhe shkarkohen nga Ortaket e shoqërisë

15.3 Administrimi i shoqërisë do te behet nga Administratoret:

Ortaket emëruan administrator te shoqërisë Z. Mentor Toma

15.4 Kohëzgjatja ne detyre e administratoreve te shoqërisë do te jete 5 (pese) vjet me te drejte ripërtëritje ne përfundim te mandatit.

15.5 Administratoret i kane te gjitha te drejtat e fuqitë për drejtimin e zakonshëm te shoqërisë, me qellim arritjen e objektivave te saj

15.6 Administratoreve i takon firma e lire dhe përfaqësimi i shoqërisë ndaj te tretëve ne veprime, procedura dhe seanca gjyqësore, arbitrazhi ose administrative.

15.7 Administratoret janë përgjegjës, sipas rastit, ndaj shoqërisë ose te tretëve për shkelje te ligjeve , për shkelje te Statutit apo dëme te kryera gjate ushtrimit te detyrës

15.8 Kompetencat kryesore te administratoreve ne shoqëri janë:

- kryejnë te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarisë tregtare te shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ortaket.
- përfaqësojnë shoqërinë tregtare.
- kujdesen për mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabël te shoqërisë.
- përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë se veprimtarisë dhe se bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve i paraqet këto dokumente përpara ortakeve për miratim.
- kriojnë një sistem paralajmërimi ne kohen e duhur për rr Ethanat, qe kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë.



- kryejnë regjistrimet dhe dërgon te dhënat e detyrueshme te shoqërisë , siç parashikohet ne ligjin për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit.
- raportojnë përpala ortakeve ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendësi te veçante për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.
- kryejnë detyra te përcaktuara ne ligj dhe statut.
- administrimin e pasurisë se Shoqërisë, duke përfshire mjetet financiare, brenda caqeve te lejuara nga ortaket.
- kryejnë e te gjitha veprimeve bankare ne interes te shoqërisë me përjashtim te tërheqjes çash te vlerave monetare te depozituara ne banke për llogari te shoqërisë.
- te përfaqësoje Shoqërinë me te tretet ne te gjithë veprimtarinë e saj dhe te mbroje interesat e saj ne gjykate apo arbitrazh, nënshkrimin e kontratave ne emër te shoqërisë dhe ndjekjen e zbatimit te tyre.
- ti propozojnë ortakeve për miratim strukturën e aparatit te Shoqërisë dhe krijimin e organeve te tjera te domosdoshme për realizimin e objektivave te Shoqërisë .
- ti propozojnë ortakeve për miratim numrin e punonjësve te Shoqërisë, pagat dhe emërimin e shkarkimin e tyre

Neni 16

Marrëveshjet e ndaluara

16.1 Administratoreve ose ortakeve qe nuk janë persona juridike nuk u lejohet te kontraktojnë ne çfarëdolloj forme qofte, te marrin hua te shoqëria, te japid pëlqimin ne emër te saj, për paradhënie si dhe te behën dorëzanes apo te garantojnë ne emër te saj angazhimet ndaj te tretëve. Ne rast te kundërt kontrata është e pavlefshme. Kjo mase ndaluese zbatohet edhe ndaj përfaqësuesve ligjore te ortakeve qe janë persona juridike.

16.2 Kjo mase zbatohet gjithashtu ndaj bashkëshorteve, paraardhësve dhe pasardhësve te personave te cituar ne paragrafin e pare te këtij neni, si dhe ndaj çdo personi ndërmjetës.

Kreu VI

VITI FINANCIAR , LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMEVE

Neni 17

17.1 Çdo vit finansiar fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtim bën viti i pare i cili fillon ne datën e regjistrimit te shoqërisë ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit.

17.2 Llogarite vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitis finanziar , raportet e veçanta te hartuara nga administratori dhe eventualisht eksperti kontabël i autorizuar, miratohen nga Ortaket.

17.3.Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarinë vjetore behet brenda 3 muajve nga mbyllja e vitis finanziar.

Neni 18

Kontrolli i Shoqërisë

18.1 Kontrolli i Shoqërisë kryhet nga një Ekspert Kontabël i Autorizuar, i emëruar nga ortaket.

18.2 Eksperti kontabël i autorizuar garanton qe llogarite vjetore te shoqërisë janë te rregullta, te hartuara me sinqueritet dhe pasqyrojnë rezultatet e vitis te kaluar finanziar, si dhe gjendjen financiare te shoqërisë. Ai verifikon librat e llogarive, si dhe fondeet e shoqërisë, kontrollon përshtatjen e kontabilitetit me ligjin ne fuqi, verifikon përputhjen me llogarite vjetore te informacionit dhe ne raportin e administrimit, kontrollon gjithë librat e llogarisë, dokumentet kontabël dhe regjistrat e proces-verbaleve. Mund te aktivizoje eksperte dhe bashkëpunëtorë për te përballuar volumin e punës, por duke marre me pare miratimin e ortakeve.

18.3 Shkarkimi i Ekspertit kontabël te autorizuar vendoset ne te njëjtat kushte si emërimi nga ana e ortakeve.

Kreu VII

PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Neni 19

19.1 Shoqëria mund te prishet ne çdo kohe dhe për çfarëdo lloj shkaku, si ne rast falimentimi, privim të drejtave për te ushtruar aktivitet tregtar, forca madhore dhe faktorë te tjere qe nuk varen nga Ortaket.

19.2 Shoqëria hyn ne fazën e likuidimit qe ne momentin e prishjes se saj. Për kryerjen e këtij procesi, ortaket emërojnë një ose disa likuidatorë, te cilët i paraqesin atij raportin mbi gjendjen



e aktivit dhe pasivit te Shoqërisë , mbi ndjekjen e operacioneve te likuidimit dhe afatin e nevojshëm te përfundimit te tyre

19.3. Ne fund te procesit te likuidimit, ortaket vendosin mbi bilancin përfundimtar financier, mbi aktin e rregullshmërisë se punës se likuiduesit, dhe mbylljen e procesit te likuidimit.

19.4. Pas pagimit te kreditoreve dhe shlyerjes se pjesëve te kapitalit themeltar tek kontribuuesit përkatës, likuidatori ndan kapitalet e mbetura për ortaket e shoqërisë.

Neni 20

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

20.1 Mosmarrëveshjet midis ortakeve, shoqërisë dhe te tretëve ne rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqësor.

Kreu VIII

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 21

21.1 Për sa nuk është e parashikuar ne ketë Statut , do t'i behet referim ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 “Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare”, si dhe legjispcionit koherent

21.2 Ky statut hartohet ne 4 (katër) kopje, secila me te njëjtën vlerë ligjore. Njëra prej kopjeve ruhet ne dokumentacionin baze te shoqërisë.

ORTAKET E SHOQERISE “Menzy” SH.P.K.

Mentor Toma



Zyhni Dika

